



Datë: 01.09.2025  
Numër Protokolli: 5881/2025

A.nr.1202/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani- kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Bajraktari Gashi-anëtare, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1202/2025, të datës 24.06.2025, të parashtruar nga ankuesi, F.G, kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.09.2025 mori këtë;

## V E N D I M

**I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.1202/2025, e datës 24.06.2025 e parashtruar nga ankuesi F.G.

**II. Mbetet** në fuqi Njoftimi i datës 17.06.2025 për pozitën Administrator i Lartë i Rrjetit Shtetëror i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

## A r s y e t i m

Ankuesi, F.G (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), me datë 24.06.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4298/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.1202/2025, kundër Konkursit të jashtëm me Nr.02/2025, të shpallur me datën 10.04.2025, nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për pozitën Administrator i Lartë i Rrjetit Shtetëror, 1 pozitë, me pretendimet ankimore se testimi me shkrim ka qenë i hartuar në mënyrë jo të drejtë, është bashkuar mbajtja e testimit me pozitën Administrator i Lartë i sistemeve dhe testimi nuk ka paraqitë drejtë detyrat dhe përgjegjësit lidhur me pozitën për të cilën kam aplikuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 22.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa kjo e fundit, më datë 31.07.2025, ka përcjellë përgjigjën në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit)**  
**administroi këto prova:** Ankesën me numër protokolli 4298/2025, të datës 24.06.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Rezultatet e testit me shkrim të datës 17.06.2025; Konkursi me nr.02/2025i datës10.04.2025; Kopja e ID-kartelës; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 22.07.2025; Përgjigje në ankesë e datës 31.07.2025 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës; Rezultatet e testit me shkrim nga Komisioni i pranimit i datës 11.06.2025; Rezultatet e intervistës me gojë nga Komisioni i Pranimit i datës 17.06.2025; Verifikimi paraprak; njoftim për testin me shkrim i datës 29.05.2025; Testi me shkrim për Administrator i Lartë i Rrjetit Shtetëror; Vendimi i datës 26.05.2025 për emërimin e komisionit të Pranimit; Formulari i vlerësimit të testit me shkrim nga komisioni i pranimit për kandidatin; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 28.02.2025 për B.T; Formulari i Vlerësimit të kandidatit në intervistë me gojë e datës 16.06.2025; kërkesa për punësim e kandidatit B.T i datës 24.04.2025 bashkë me dokumentet e kërkuara; Kërkesë për punësim për kandidatin F.G e datës 02.05.2025 bashkë me dokumentet e kërkuara.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa është e pranueshme sipas dispozitave ligjore dhe është lëshuar në shqyrtimin meritore dhe si rrjedhojë ka gjetur se ankesa e ankuesit, **është e pabazuar**, sepse:

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit në pikëpamje të kompetencës lëndore të Këshillit për vendosje lidhur me këtë çështje administrative, ju referua nenit 6, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: “4. Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë”, kështu që, nisur nga ky referim ligjor rrjedhë së të punësuarit në administratë të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor kanë statusin e nëpunësit civilë me status të veçantë dhe së mbi këtë bazë ligjore Këshilli Gjyqësor me akt të veçantë ligjor ka rregulluar procedurën e pranimit të nëpunësve civilë në këtë institucion gjegjësisht me Rregulloren Nr. 01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Kolegji i Këshilli, ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”, ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet administrative të ndërmarra në procedurën e pranimit për pozitën Administrator i Lartë i Rrjetit Shtetëror, në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe si rrjedhojë Kolegji ka gjetur se si kërkesa të përgjithshme për këtë pozitë të punës janë përcaktuar: **-Arsimi i kërkuar:** Diploma universitare të vlefshme në Kosovë: Shkencat Kompjuterike; **-Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku tri (3) vit përvojë pune profesionale. Certifikata në administrimin e sistemeve e dëshirueshme Andaj Kolegji i Këshillit konstaton se shpallja e konkursit për pozitën përkatëse është në pajtim Rregullore nr. 24/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr.02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor respektivisht nenit 6 paragrafi pika 3.7.

Ndërlidhur si me lartë, Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit mori parasysh dispozitat e Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, me theks të veçantë :

- Nenin 3, [Parimet për pranim]: *Pranimi në detyrë i të punësuarve në administratën e sistemit gjyqësor bazohet në procedurë të hapur dhe konkurruese duke siguruar profesionalizëm, integritet, mos-diskriminimin, transparencën, pavarësinë, paanshmërinë, meritokracinë, si dhe të pasqyroj*

*natyrën shumë etnike dhe parimet e barazisë gjinore siç janë të garantuara në Kushtetutën e Republikës, marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe në ligjet e aplikueshme të Republikën e Kosovës.*

- Nenin 7 [Komisioni i Pranimit]: 1. *Vlerësimi profesional i kandidateve për emërim në një pozitë të kategorisë profesionale behët nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit për kategoritë profesionale ka pesë (5) anëtarë të rregullt dhe për secilën kategori të anëtareve të komisionit caktohet një anëtarë zëvendësues, në këtë përbërje: 2.1 tre (3) nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues apo të ulet drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilën zhvillohet konkurrimi ku njëri nga ta caktohet Kryetar i Komisionit; 2.2. një (1) përfaqësues nga NJMBNJ; dhe 2.3 një (1) nëpunës i kategorisë profesionale i fushës përkatëse për të cilën zhvillohet konkurrimi.*

- Nenin 17 [Vlerësimi profesional i kandidatëve]: 1.*Vlerësimi profesional i kandidatëve, zhvillohet nga komisioni i pranimit dhe përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 2.Vlerësimi profesional i kandidatëve zhvillohet në dy faza : 2.1. Faza e parë: vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim; dhe 2.2. Faza e dytë: vlerësimi nëpërmjet intervistës me gojë....,*

- Nenin 19 [Testi me shkrim]: 1.*Testi me shkrim, përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje me përgjigje të shumëfishtë me një përgjigje të saktë prej të cilave: dhjetë (10) pyetje nga njohuritë e përgjithshme institucionale dhe pesëmbëdhjetë (15) pyetje me njohuri që lidhen me vendin e punës dhe katër (4) ese të shkurtra, me maksimum njëqind (100) fjalë, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara për pozitën e shpallur. 2. Secila përgjigje e saktë e pyetjeve me përgjigje të shumëfishtë nga testi me shkrim sipas paragrafit 1 të këtij neni, vlerësohet me një pikë gjatë (1.6) pikë dhe në këtë pjesë kandidati mund të fitojë dyzet (40) pikë, ndërsa eset mund të vlerësohet me tridhjetë (30) pikë apo secila ese më se shumti me nga shtatë pikë pesë (7.5) pikë. 3.Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4.Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim.....*

- Nenin 20 [Vlerësimi i testit me shkrim], ku përcaktohet se: 1.*Vlerësimin e testit me shkrim e bënë komisioni i pranimit dhe atë më së largu në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e mbajtjes së provimit, përveç rasteve kur kemi numër të madh të testeve për të vlerësuar dhe kjo duhet arsyetuar me shkrim nga kryetari i komisionit. 2.Komisioni në ditën kur fillon vlerësimi hap pakon ku gjenden plikot e formatit A-4 dhe vlerëson testin me shkrim në bazë të kodit të shënuar në plikon A-4 në të cilën ndodhet testit pa ditur të dhënat e kandidatit. 3.Komisioni do të diskualifikojë secilin test i cili mund të ketë një shenjë identifikuese të bërë me qëllim. 4.Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë, për të gjitha kategoritë, vlerësohen duke u bazuar në saktësinë e përgjigjes dhe duke fituar numrin e pikëve për secilën pyetje ashtu siç është përcaktuar në nenin 19 paragrafi 2, varësisht nga kategoria e pozitës për të cilën është mbajtur testi. 5.Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e komisionit të pranimit në mënyrë individuale dhe mbledhja e pikëve të secilit anëtar të komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e komisionit. 6.Vlerësimi minimal apo maksimal i esesë duhet të arsyetohet me shkrim nga vlerësuesi. 7.Shuma e pikëve të vlerësuar nga paragrafi 4 dhe 5 përbën vlerësim përfundimtar të testimit me shkrim për një kandidat.... 8.Formularët e vlerësimit të cilët janë të identifikuar si kod plotësohen dhe nënshkruhen nga komisioni i pranimit dhe bashkohen me plikot e formatit A-4 që përmban të njëjtin kod.*

Andaj, referuar kuadrit ligjor si me lartë, Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës ka konstatuar se përbërja e Komisionit të Pranimit, i themeluar sipas Vendimit me numër protokolli DS-309/2025 të datës 26.05.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është në pajtueshmëri me kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 7 të Rregullores Nr. 01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor. Tutje, lidhur me fazën e vlerësimit të testit me shkrim të kandidateve, Kolegji i Këshillit, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se testi me shkrim është hartuar në formatin e kërkuar sipas nenit 19 të Rregullores Nr.01/2024, gjegjësisht pjesa e parë lidhur me njohuritë e

përgjithshme institucionale, ka përfshirë 10 pyetje më zgjidhje të shumëfishtë, pjesa e dytë e testit përkitazi më njohuritë lidhur me vendin e punës ka përmbyjt gjithsej 15 pyetje me zgjidhje të shumëfishtë, dhe pjesa tretë e testit që ka të bëjë më ese ka përmbyjt 4 ese të shkurtra. Ndërsa, Kolegji i Këshillit nga analizimi i testit me shkrim të ankuesit ka konstatuar së në pjesën e parë, ka grumbulluar 14,4 pikë, në pjesën e dytë ka grumbulluar 16 pikë , kurse në pjesën e esëve është vlerësuar me gjithsej 8 pikë nga 30, duke arritur kështu gjithsejtë 38.4. pikë nga vlerësimi i testit me shkrim, si rrjedhojë në kuptim të paragrafit 4 të nenit 19 të kësaj rregulloreje, e njëjti nuk ka kaluar pragun e kalueshmërisë së testit me shkrim dhe nuk ka fituar të drejtën për pjesëmarrje në intervistën me gojë.

Kolegji ka trajtuar pretendimin e ankuesit se janë bashkuar dy teste në njëjtën testim për dy pozita Administrator i Lartë i Rrjetit Shtetëror dhe Administrator i Lartë i Sistemit, por meqenëse testimi ka qenë i njëjtë për të gjithë pjesëmarrësit ka konstatuar se nuk është bërë ndonjë diskriminim lidhur me të drejtën e kandidatëve që kanë marrë pjesë në testimin me shkrim, ndërsa sa i përket vlerësimit të esesë ankuesi është përgjigjur shumë shkurt dhe vlerësimi është i tillë nga ana e Komisionit, nga dukja vizuale shihet se esetë janë përgjigje shumë të shkurtra.

Kolegji i Këshillit, më qëllim të konstatimit të ligjshmërisë lidhur me këtë procedurë të zhvilluar në bazë të ligjit ka shqyrtuar edhe aplikacionin e kandidat që është shpallur fitues B.T dhe ka konstatuar se i njëjti posedon diplomën Nr.329/45-64 me të cilën dëshmohej se ka diplomuar me datë 10.10.2018 ka marr gradën Bachelor i Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri, me përvoj pune sipas vërtetimit të datës 22.04.205 nr.327/25 të lëshuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës me të cilin dëshmohej se i njëjti është i punësuar në pozitën Zyrtar i TI nga data 21.08.2021 dhe vazhdon edhe tutje, andaj kandidati B.T ka plotësuar kushtet sipas kriterëve formale të konkursit.

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës, dhe meqenëse nuk është evidentuar ndonjë shkelje esenciale e karakterit procedural apo material dhe duke qenë së pretendimet ankimore nuk janë vërtetuar si të bazuara, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundim së procedura e pranimi sipas Konkursit të Jashtëm Nr.02/2025 të datës 10.04.2025, për një (1) pozitë të punës “Administrator i Lartë i Rrjetit Shtetëror”, është zhvilluar në pajtim me nenin 39 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë si dhe dispozitat e Rregullores Nr. 01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimi, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Kështu që, thënë si me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
LËNDA A.nr.1202/2025

**Sabile Avdyli**

*Procesmbajtëse*

**Eshref Shabani**

*Kryetar i Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit, F.G;
- Njësisë se Personelit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.